

VENDIM
Nr. 571, datë 22.7.2020

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 591, DATË 5.9.2007, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PERSONALITETEVE TË TJERA TË
LARTA SHTETËRORE TË VENDIT, QË DO TË RUHEN DHE MBROHEN NGA
GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas shkronjës “e”, të pikës 1, të vendimit nr. 591, datë 5.9.2007, të Këshillit të Ministrave, shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:

“ë) Kryenegociatorin për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, me truprojë–shofer, gjithsej 2 nënoficerë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama